

Vendim nr. 190 datë 19.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATMIR NDREU**, përfaqësuar nga avokat Emin Saraçi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5400, datë 04.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Neni 4, 15, 16, pika 2, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë, me vendimin nr. 1605, datë 14.02.2019, i ka caktuar Fatmir Ndreut (*kërkuesi*) pension invaliditeti në vlerën 18.769 lekë në muaj, të llogaritur për një periudhë sigurimi prej 28 vjetësh e 8 muajsh, me të

drejtë pagese nga data 30.08.2019. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim, duke kërkuar rishikimin e masës së pensionit për pretendimin se nuk ishin përfshirë në llogaritje disa periudha sigurimi. DRSSH-ja, Tiranë, me vendimin nr. 1605/1, datë 01.03.2019, ka rishikuar vendimin e tij duke përfshirë në llogaritje periudhën e sigurimit/vjetërsisë në punë për vitet 1984-1993 të pretenduar nga kërkuesi dhe, për pasojë, ka caktuar për të një masë më të lartë pensioni invaliditeti, konkretisht në vlerën 24.173 lekë në muaj.

2. Kërkuesi ka paraqitur ankim administrativ kundër vendimit të rishikuar të DRSSH-së, Tiranë, për të cilin Komisioni Rajonal i Ankimit (*KRA*), me vendimin nr. 395, datë 20.05.2019, ka vendosur rrëzimin e tij. Në vijim, mbi ankimin e kërkuesit, Komisioni Qendror i Ankimit (*KQA*) pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*), me vendimin nr. 1077, datë 17.07.2019, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të kërkesës së kërkuesit pranë DRSSH-së Tiranë, duke lënë edhe detyrat përkatëse.

3. Gjatë rishqyrtimit, pasi ka plotësuar detyrat e lëna, DRSSH-ja, Tiranë i ka njohur kërkuesit një periudhë sigurimi prej 40 vjetësh dhe mbi këtë bazë ka rillogaritur masën e pensionit të invaliditetit në shumën 25.240 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 08.09.2018. Kërkuesi ka paraqitur sërish ankim administrativ, i cili është rrëzuar nga KRA-ja ku, në vijim, edhe nga KQA-ja, me vendimin nr. 208, datë 24.02.2020, me argumentin se nuk provohej periudha e sigurimit/vjetërsisë në punë për periudhën 06.03.1978 - 31.12.1979 e pretenduar prej tij pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit Dibër.

4. Në datën 03.08.2020 kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të vendimeve të organeve të sigurimeve shoqërore dhe detyrimin e tyre t'i rillogarisnin pensionin e invaliditetit duke përfshirë në llogaritje vjetërsinë në punë pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit Dibër dhe periudhën e trajtimit me pagesë invaliditeti për periudhën 2002 - 2008, si dhe t'i paguajnë atij diferencën e papaguar të pensionit të invaliditetit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1569 (80-2021-1603), datë 20.05.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim, pas ankimit të kërkuesit, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin 256 (86-2023-388), datë 06.04.2023, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5400, datë 04.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

5. Në datën 06.07.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 09.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:
 - 6.1. E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:
 - 6.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi vendimmarrja e gjykatave i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë duke mos marrë një zgjidhje përfundimtare për problemin e tij.
 - 6.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shpallur datën e gjykimit duke i hequr kërkuesit mundësinë që të paraqiste prova të reja dhe pretendime shtesë, përveç se, duke qenë se gjykimi u zhvillua në dhomën e këshillimit, ai nuk pati mundësi të kërkonte bërjen e një ekspertimi për shumën e pensionit të invaliditetit.
 - 6.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit pa ia nënshtruar çështjen debatit gjyqësor, si dhe me një analizë e arsytim sipërfaqësor e jo bindës.
 - 6.2. *E drejta për t'u rehabilituar dhe zhdëmtuar*, e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës si rrjedhojë e procesit të parregullt ligjor të zhvilluar nga gjykatat.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji çmos se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 04.12.2023 të Gjykatës së Lartë dhe kopja e tij i është dërguar avokatit të kërkuesit në adresën e tij elektronike në datën 07.03.2024. Ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 06.07.2024, sipas shërbimit postar, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit së bashku me të drejtën për t’u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe cenimin e së drejtës për t’u rehabilituar dhe zhdëmtuar, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës. Në lidhje me këtë të fundit, Kolegji do të mbajë në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkuesi lidhen tërësisht me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, për rrjedhojë çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës. Prandaj, në vijim, Kolegji do të analizojë pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit së bashku me të drejtën për t’u dëgjuar, si dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe së drejtës për t’u dëgjuar

12. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shpallur datën e gjykimit duke i hequr kërkuesit mundësinë që të paraqiste një provë të re, vërtetim për

vjetërsinë në punë të DRSSH-së, Dibër dhe pretendime shtesë. Gjithashtu, duke qenë se gjykimi u zhvillua në dhomën e këshillimit, ai nuk pati mundësi të kërkonte bërjen e një ekspertimi për shumën e pensionit të invaliditetit.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij, pra t'u jepen mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Prandaj, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se, para së gjithash, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po në këtë kuptim, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të këtij shqyrtimi kushtetues, Kolegji vëren se në pritje të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit nga kërkuesi janë paraqitur katër kërkesa për përshejtim të gjykimit dhe konkretisht në datat 20.09.2021, 07.02.2022, 02.09.2022 dhe 16.01.2023. Gjyqtari relator i çështjes, në datën 24.02.2023, ka disponuar me vendim për përshejtimin e gjykimit të saj në dhomën e këshillimit, konkretisht në periudhën mars - maj 2023. Ky vendim i është njoftuar rregullisht kërkuesit dhe palëve të tjera në proces. Në vijim, në datën 27.02.2023, gjyqtari relator ka marrë vendim për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të datës 06.04.2023, ora 09:05, ndërsa në dosjen gjyqësore gjendet i administruar dhe akti i njoftimit me shpallje i datës 27.02.2023, ku në listën e çështjeve për shqyrtim të datës 06.04.2023 përfshihej edhe

çështja e kërkuarit. Ndërkohë, ky i fundit nuk rezulton të ketë paraqitur parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit.

16. Gjithashtu, Kolegji konstaton se prova e re e pretenduar nga kërkuari në mbështetje të faktit të periudhës së sigurimit/vjetërisë në punë, konkretisht vërtetimi i DRSSH-së, Dibrë nr. 965 prot., datë 01.12.2021, është siguruar nga ai në vitin 2021, ndërkohë që gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit është zhvilluar pas më shumë se një viti, në prill 2023. Nisur nga kjo, Kolegji vëren se kërkuari, megjithëse i ka pasur të gjitha mundësitë, nuk i ka kërkuar gjykatës së apelit marrjen e kësaj prove të re, duke i parashtruar edhe arsyet e pamundësisë së tij për ta paraqitur atë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë.

17. Për sa i takon gjykimin të çështjes në dhomën e këshillimit, Kolegji thekson se nenet 49 dhe 51 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, kanë parashikuar rastet se kur Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore dhe se përcaktimi i këtyre rasteve është në kompetencë të saj. Fakti se çështja është gjykuar në dhomën e këshillimit është i pamjaftueshëm për të mbështetur pretendimin e kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

18. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk duket të ketë vepruar në mosrespektim të ligjit procedural për sa i përket njoftimit të palëve me shpallje, përkundrazi, ka vepruar në përputhje me të duke garantuar për palët dhe, në veçanti për kërkuarin, të drejtën për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe njoftimin e rregullt si element të këtij procesi. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe së drejtës për t’u dëgjuar, janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi vendimmarrja e gjykatave atij i ka mohuar të drejtën për të marrë një zgjidhje përfundimtare për problemin e tij. Gjithashtu, sipas tij, është cenuar edhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa ia nënshtruar çështjen debatit gjyqësor, si dhe me një analizë e arsytim sipërfaqësor e jo bindës.

20. Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, në jurisprudencën

kushtetuese është theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, rezulton se ka qenë kërkuesi ai që ka vënë në lëvizje gjykatën e shkallës së parë, e cila është shprehur në themel për kërkesëpadinë e tij, duke vendosur rrëzimin e saj. Po kështu, përmes ushtrimit të mjetit të ankimit, kërkuesi ka vënë në lëvizje dhe gjykatën e apelit, e cila edhe ajo është shprehur për themelin e çështjes, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, kërkuesi ka vënë në lëvizje edhe Gjykatën e Lartë, e cila pasi e ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, duke mbetur kështu të pacenuara vendimet e gjykatave më të ulëta që kanë zgjidhur çështjen në themel. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesit i është garantuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje nga ajo.

23. Për sa i përket vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, rezulton se ai është marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit. Vendimi tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i

pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij dhe kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e tij.

24. Si konkluzion, Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, megjithëse me arsyetim të kufizuar, në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.

25. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuetit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.